V E N D I M
Nr.374, datë 27.5.2001

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR.73, DATË 15.2.2001 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR KRITERET DHE MASËN E TRAJTIMIT TË VEÇANTË TË PUNONJËSVE QË KANË PUNUAR NË MINIERA NË NËNTOKË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8685, datë 9.11.2000 "Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë", me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale dhe të Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Pas pikës 1 të vendimit nr.73, datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 1.1 me këtë përmbajtje:

" 1.1 Për efekt trajtimi sipas këtij ligji, punonjës që kanë punuar në miniera në nëntokë konsiderohen punonjësit e nëntokës të minierave, të ndërmarrjeve të ndërtim-minierave dhe të gjeologjisë" .

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare

KRYEMINISTRI
Ilir Meta